



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE
DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1575 prot.

Korçë, më 22.02.2021

Lënda: Dërgim i planit vjetor të pranimi në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2021

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT
Bulevardi "B. Curri", pranë ish-hotel Arbana, Tiranë

Të nderuar,

Bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe në VKM nr. 108 datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil" bashkëngjitur po ju dërgojmë VKB nr. 14 datë 04.02.2021 "Për miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë"

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË
Sotirag Filo





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KORÇË

Vendim

Nr. 14 Datë 4-2-2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR
INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2021**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” dhe urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 23 datë 12.01.2021 “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2021”

VENDOSI:

1. Te miratojë planin vjetor 2021 të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë.
2. Numri i vendeve vakante për të cilat do të shpallet konkurimi të jetë 65 i ndarë sipas kategorive si më poshtë:
 - 1 vend vakant për nëpunës të nivelit të lartë drejtues (drejtor drejtorie të përgjithshme).
 - 5 vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie)
 - 16 vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues (përgjegjës sektori)
 - 43 vende vakante për nëpunës të nivelit ekzekutiv (specialistë)
3. Vendet vakante të nëpunësve të nivelit ekzekutiv (gjithësej 43) të klasifikuara sipas grupeve të administrimit të jenë si më poshtë:
 - Pozicionet e administrimit të përgjithshëm janë **16 vende vakante**, më konkretisht, 1 specialist për kontrollin jo ushqimor dhe liçensimin dhe 1 specialist për tregjet në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit (Drejtoria e Kontroll Territorit), 1 Specialist për Emergjencat Civile në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe shërbimeve Mbështetëse), 2 specialistë në Sektorin e Integritetit Europian, 2 specialistë në Sektorin e Turizmit, 2 specialistë në Sektorin e Projekteve, 2 specialistë në Sektorin e Migracionit dhe Diaspores dhe 1 specialist në Sektorin e Teknologjive të Informacionit në Drejtorinë e Projekteve, Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Migracionit dhe Diaspores, 1 specialist në Sektorin për Informimin

Qytetar në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar dhe 3 Specialistë ndërlidhës komunitare me kohë të pjesëshme.

- 1 specialist për rregjistrimin, vlerësimin dhe shërbimit të taksapaguesve (familjarë), 1 specialist për rregjistrimin, vlerësimin dhe shërbimit të taksapaguesve, 1 specialist për kontrollin dhe mbledhjen e të ardhurave në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit (Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore), 1 specialist i logjistikës në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe shërbimeve Mbështetëse), 1 specialist për buxhetin në Drejtorinë e Financës gjithsej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin ekonomist.
- 1 specialist për shërbimet veterinarë në Njësinë Administrative Korçë, 1 specialist për shërbimet veterinarë në Njësinë Administrative Bulgarec, Voskop, Voskopojë dhe Lekas si dhe 1 specialist për shërbimet veterinarë Njësitë Administrative Drenovë, Mollaj dhe Vithkuq, në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit, gjithsej **3 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në një nga degët e Fakultetit të Veterinarisë, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin veterinar.
- 2 specialistë për menaxhimin e aseteve në pronësi të Bashkisë Korçë në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria Juridike) gjithsej **2 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Drejtësisë, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin jurist.
- 2 inspektor të lartë auditimi në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, dhe 1 specialist për të Dhënat e Konkurentëve në Drejtorinë e Prokurimeve dhe gjithsej **3 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimin në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë dhe/ose në Fakultetin e Drejtësisë, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin jurist dhe/ose ekonomist. Pozicionet e inspektorëve të lartë të auditimit në Drejtorinë e auditit të Brendshëm duhet të jenë të certifikuar si të tillë nga Ministria përkatëse.
- 1 specialist projektues, 2 specialistë për infrastrukturën mjedisore dhe 1 specialist për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave demografike, etj. në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, 1 specialist topograf në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria Juridike) si dhe 2 specialistë për çështjet urbane gjithsej **7 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në fushën e urbanistikës, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, topografisë etj, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin urbanist, arkitekt, inxhinier ndërtimi, topograf etj.

- 1 specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Drejtorinë e Kujdesit Social, gjithsej **1 pozicion** i cili kërkon njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Shkencave Humane, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin sociolog, psikolog, punonjës social etj.
 - 5 specialistë për agronomë në Sektorin e Bujqësisë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithsej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Agronomisë, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin agronom.
 - 1 specialist Pyjesh në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithsej **1 pozicion** i cili kërkon njohuri të posaçme dhe arsimim në fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit/ Pyjeve etj. , në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin përkatës.
4. Plotësimi i vendeve vakante të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, të mesëm e të ulët drejtues (gjithësej 22) të bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.
5. Përjashtohen nga rregulli i përmendur në pikën 4 të këtij vendimi pozicionet e mëposhtme:
- Drejtori i Drejtorisë së Projekteve, Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Migracionit dhe Diaspores;
 - Përgjegjës i Sektorit për Emergjencat Civile;
 - Përgjegjës i Sektorit të Turizmit;
 - Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave.
- Rekrutimi i nëpunësve vetëm për këto pozicione do të kryhet nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil pasi të jenë ezauruar procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
6. Institucioni ku janë planifikuar vendet vakante është Bashkia Korçë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe shpallet në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar dhe Punësimt dhe atë të Bashkisë Korçë.

KRYETAR I KËSHILLIT

Erjon Nexhipi

